

UDHËZIM
Nr.2347, datë 14.12.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.1468, DATË 26.06.2006 “PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.223, DATË 19.04.2006 “PËR PAGESËN E TË ARDHURËS NGA PAPUNËSIA””

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të pikës 12 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.223, datë 19.4.2006 “Për pagesën e të ardhurës nga papunësia”, Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 1468, datë 26.06.2006 “Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.223, datë 19.04.2006 “Për pagesën e të ardhurës nga papunësia””, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Pika 13 riformulohet me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“13. E ardhura nga papunësia caktohet mujore dhe paguhet përpjestimisht me numrin e ditëve kalendarike, për kohën që përfituesi ka të drejtë ta marrë këtë të ardhur. Pagesa jepet një herë në muaj pranë bankës, pasi personi përfitues të jetë paraqitur në zyrën e punësimit. Ajo i jepet vetëm personit përfitues, përkundrejt paraqitjes në bankë të dokumentit të identifikimit ose kartës së debitit.”

2.Pika 21 riformulohet me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“21. Në rastet kur personi përfitues i të ardhurës nga papunësia, ndryshon vendbanimin pasi i është caktuar përfitimi i të ardhurës nga papunësia në vendbanimin e mëparshëm, me kërkesë të personit të interesuar, zyra përkatëse e punësimit bën transferimin e dosjes me dokumentacionin, në zyrën e punësimit ku ka vendbanimin aktual personi.

3. Pas pikës 21, shtohet pika 21/1 me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“21/1 Punëkërkuksi i papunë, i cili qendrën e fundit të punës e ka në juridiksionin e një zyre tjetër kompetente punësimi nga vendbanimi aktual, fillojnë procedurat për përfitimin e të ardhurës nga papunësia, pasi të ketë konfirmuar formularin e dyfishtë në organet e sigurimeve shoqërore ku ka qenë qendra e fundit e punës së tij, ndërsa caktimi i përfitimit i bëhet në zyrën e punësimit ku ka vendbanimin aktual.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
SPIRO KSERA